

Nr. Prot. 2024/12

Tiranë, më 17 korrik 2024

Për: Z. Fatmir Xhafaj
Kryetar i Komisionit të Posaçëm Parlamentar "Për thellimin e reformave për mirëqeverisjen, sundimin e ligjit dhe antikorrupsionin për Shqipërinë 2030 në Bashkimin Evropian", Kuvendi

Për dijeni: Z. Genci Gjonçaj
Sekretar i Përgjithshëm, Kuvendi

Lënda: Përgjigje shkresës me Nr. prot. 2820, datë 12.07.2024

I nderuar Z. Xhafaj,

Dëhsirojmë t'ju falënderojmë për ftesën e bashkëpunimit me organizatën tonë për t'iu bashkuar tre fushave të punës së këtij Komisioni të Posaçëm. Në vijimësi të shqyrtimit të kërkesës ju informojmë se nga ana jonë do të jenë përfaqësues për secilën fushë ekspertët si më poshtë:

- Z. Floran Pustina, Partner pranë Tashko Pustina për fushën "mirëqeverisja"
- Z. Ened Topi, Drejtues i Lartë pranë Deloitte Legal për fushën "antikorrupsioni"
- Z. Oltjon Dano, Partner pranë Kalo & Associates për fushën "shteti i së drejtës"

Gjithashtu, nëse do të ishte e mundur, do të ishte me vlerë për ne për të ndjekur sa më mirë kontributin të mund të jetë edhe Zj. Ardita Seknaj, Sekretar i Përgjithshëm pranë ICC Albania e mundshme për të marrë pjesë në takime, qoftë edhe si *ex-officio*.

Lidhur me punën tonë të deritanishme, po ndajmë me ju disa dokumente të cilat janë hartuar me fokus çështje të ndryshme mbi promovimin dhe forcimin e praktikave të mira të integritetit që prekin sektorin privat kryesisht.

- [Klauzola e ICC antikorrupsion](#) (version i 2012, është përkthyer në shqip dhe aktualisht po rihikohet për përditësim)
- [Rregullat anti-korrupsion](#) (version i 2023, së shpejti në shqip)
- [Good Governance Index](#) (2022)
- [Konsultimi publik me sektorin privat mbi procesin e integritetit në BE](#) – whitepaper (2022)
- [Studim analitik mbi Mekanizmat për Shqyrtimin e Investimeve](#) (2023)

Duke ju falenderuar për konsideratën, mbetemi në dispozicion për çdo paqartësi.

Me respekt,


Bulgen Aldan
Kryetar i Bordit Drejtues




Ardita Seknaj
Sekretar i Përgjithshëm